



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**Nr. i Dokumentit: 21.9.1-2017-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË**  
**ADMINISTRATËS PUBLIKE**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

**Prishtinë, maj 2018**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Administratës Publike, në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Florim Maliqi (udhëheqës ekipi) dhe Qendresa Sogojeva e Lumturije Sopi, (anëtare ekipi), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Samir Zymeri.

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	22
5 Qeverisja e mirë.....	23
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	27
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme .....	29
Shtojca III: Letërkonfirmimi .....	34

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Administratës Publike (MAP) për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, për vitin 2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit (ZKA) për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Administratës Publike.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Ministrisë për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar me Theksim të Çështjes

Sipas mendimit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

#### Theksim i Çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shuma prej 313,160€ ishin buxhetuar dhe shpenzuar si investim/pasuri kapitale, mirëpo sipas natyres janë mallra dhe shërbime.

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**

Theksimi i çështjes pasqyron dobësitë në buxhetimin dhe realizimin e shpenzimeve për kategori (nga kategoria investime kapitale janë paguar projekte që i takojnë mallra dhe shërbime).



Ministri duhet t'i analizojë arsyet për Theksimin e Çështjes në auditimin e vitit 2017 dhe t'i marrë veprimet që kërkohen për të mundësuar prezentimin e drejtë dhe të saktë të pasqyrave financiare. (shih nën kapitullin 2.1)

Mangësi janë vërejtur në menaxhimin e personelit përkatësisht shtesave, shpenzimet për mallra dhe shërbime, si dhe avancet e pa mbyllura.



Ministri duhet të siguroj se ka kontrole të mjaftueshme në këto fusha. Menaxhim i duhur i shtesave të punëtorëve, specifikacione cilësore nga njësitë kërkuese si dhe avancet të mbyllen brenda afatit ligjor. (shih nën-kapitullin 3.4).

Menaxhimi i kontratave për projekte përcjellët me mangësi dhe dobësi, rreth avanceve, punëve shtesë si dhe pranimi dhe pagesa e punëve të pakryera.



Ministri duhet të rrisë kontrollet dhe të zvogëloj rreziqet në këtë fushë. Projektet të jenë të analizuar dhe shqyrtuar mirë nga njësitë kërkuese duke zvogëluar në minimum aplikimin e punëve shtesë, avancet të arsyetohen mjaftueshëm dhe të ketë kontrole rigoroze në pranimin e punëve. (shih nën-kapitullin 3.5).

Qeverisja dhe kontrollet menaxheriale përcjellën me mangësi, rekomandimet për dy vitet paraprake nuk po adresohen ashtu siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës.



Ministri duhet të zbatoj proces cilësor në menaxhim dhe kontrole, plani i veprimit për rekomandimet e viteve paraprake të monitorohet dhe zbatohet, Çështjet/ progreset kyçe t'i raportohen menaxhmentit në baza mujore. (shih kapitullin 4).

**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Ministri është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare, të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e MAP-t. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e Menaxhmentit ndaj gjetjeve tona mund të gjenden në Shtojcën III.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinioni i Pamodifikuar me Theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV të Ministrisë së Administratës Publike për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren e MF nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar të Organizatave Buxhetore.

#### Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

#### Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se ministria ka bërë pagesa në emër të shërbimeve për reforma në administratën publike nga kategoria e investimeve kapitale në shumë prej 313,160€. Qëllimi i marrëveshjes me operatorin ekonomik ishte përfitimi në shërbime përkatësisht në zhvillimin e reformës në administratën publike. Shpenzimet e ndodhura ishin aprovuar me tabelat e buxhetit për vitin 2017 si investime kapitale, por projekti i paraqitur në tabelë, nuk përmbushë

kushtet që të trajtohen si projekt kapital. Gabimet kanë të bëjnë me planifikimet fillestare nga ministria dhe aprovimet jo adekuate nga ana e Ministrisë së Financave. Kjo ndikon në mbivlerësimin e pasurive të regjistruara dhe të prezantuara në PFV për shumën e lartcekur.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV**

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administratës Publike është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.



---

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga Ministria e Administratës Publike (MAP) kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Pajtueshmërinë me rregullat financiare nr.01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Raportet tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë;
- Raportet e progresit për projektet kapitale me vlerë mbi 10,000€;
- Raportet për faturat e papaguara;
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit; dhe
- Raporti i kontratave të nënshkruara të prokurimit.

Shuma e pasurive jo financiare mbi 1,000€ e prezantuar në PFV nuk ishte e saktë. Këtë çështje më gjerësisht e kemi trajtuar tek nënkapitulli 2.1 Opinioni auditimit.

Deklarata e bërë nga menaxhmenti i MAP-it

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PVF-ve në MF mund të konsiderohet e saktë, ndonëse ekzistojnë gabime që kanë ndikuar në theksim të çështjes, por nuk kanë ndikuar në modifikimin e opinionit të auditimit.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

**Rekomandimi 1** Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet që kanë ndikuar për Theksim të Çështjes, si dhe të merren veprimet e duhura për të siguruar prezantim të drejtë dhe të saktë të PFV, përmes regjistrimit/klasifikimit të plotë dhe të drejtë të shpenzimeve dhe të pasurive.

### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

#### Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh kyçe në sistemet financiare, megjithatë kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të arrihet vlera për parane dhe të sigurohet menaxhim efektiv nga MAP. Nga vet-vlerësimi i MAP-it vërehet se ka ende pika të cila kanë nevojë për përmirësimi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Prandaj, fushat kryesore që janë vërejtur mangësi janë: planifikimi, menaxhimi dhe monitorimi i projekteve kapitale, vlerësimi i nevojave para se të iniciohen procedurat e prokurimit, menaxhimi i asetëve jo kapitale, menaxhimi jo i duhur i obligimeve, etj. Përveç tyre, MAP ka pasur një numër të konsiderueshëm të aneks kontratave, kjo paraqet një sfidë për menaxhmentin dhe kërkon fokus të veçantë në planifikimin e projekteve në mënyrë me të hollësishëm.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>18,586,374</b>	<b>19,708,075</b>	<b>19,597,632</b>	<b>17,177,447</b>	<b>21,122,876</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	18,586,374	19,682,607	19,580,107	16,880,628	20,790,086
Donacionet e jashtme	0	25,468	17,525	37,523	13,691
Financim nga huamarrjet	0	0		259,296	319,099

Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar ishte më i lartë për 1,121,701€. Rritja prej 1,096,233€ është bërë me vendim të Qeverisë, nga Granti Qeveritar. Ndërsa vlera prej 25,468€ është nga donacionet e jashtme. Për dallim nga dy vitet e kaluara, në vitin 2017 MAP nuk ka pasur financime nga huamarrjet.

<sup>1</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Në vitin 2017, MAP ka shpenzuar 99% të buxhetit final ose 19,597,632€, apo ngjashëm sikur dy vitet paraprake 2016 dhe 2015.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>18,586,374</b>	<b>19,708,075</b>	<b>19,597,632</b>	<b>17,177,447</b>	<b>21,122,876</b>
Pagat dhe Mëditjet	2,042,922	2,076,921	2,063,194	2,037,671	1,970,949
Mallrat dhe Shërbimet	4,773,852	6,605,054	6,538,365	5,067,846	5,893,800
Shërbimet komunale	2,499,600	2,471,100	2,470,035	2,265,998	2,280,090
Subvencionet dhe Transferet	-	-	-	50,000	49,000
Investimet Kapitale	9,270,000	8,555,000	8,526,038	7,755,932	10,929,037

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 33,999€. Kjo rritje ishte bërë më vendim të Qeverisë prej 7,572€ në emër të zbatimit të marrëveshjes së Brukselit për integrimin/punësimin e katër personave të komunitetit serb. Përderisa shuma prej 26,427€ ishte me rishikim të buxhetit;
- Buxheti final në kategorinë për mallra dhe shërbime ishte rritur për 1,831,202€. Shuma prej 8,900€ ishte bërë me kërkesë nga MAP në Ministrinë e Financave për transferimin e mjeteve nga shpenzimet komunale. Shuma prej 824,781€ në bazë të vendimeve të Qeverisë dhe pjesa tjetër më rishikim të buxhetit. Po ashtu donacionet e jashtme ishin 25,468€, prej tyre 17,525€ ishin shpenzuar në kuadër të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve;
- Buxheti për shërbimet komunale ishte reduktuar për 28,500€ si rezultat i bartjes së 8,900€ në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve si dhe pjesa tjetër me rishikim të buxhetit. Mirëpo, në fund të vitit 2017 obligimet e papaguara ishin 45,000€ duke tejkaluar ndarjet buxhetore, për 43,935€;
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte reduktuar për 715,000€, prej kësaj shume, 615,000€ me rishikim të buxhetit dhe 100,000€ me vendim të Qeverisë. Niveli i ekzekutimit të buxhetit final ishte rreth 100%. Programi për Investime Publike (PIP) përfshin 30 projekte të bartura nga viti i kaluar, pesë prej tyre nuk kishin filluar fare të realizohen në vitin aktual.

**Çështja 2 - Realizimi i buxhetit**

- E gjetura** Në kategorinë e investimeve kapitale buxheti është shpenzuar/realizuar në nivel të lartë, mirëpo realizimi/finalizimi i projekteve është në nivel të ulët dhe jo të kënaqshëm. Sipas raportit për progresin e projekteve kapitale, është vetëm një projekt i finalizuar deri në fund të vitit 2017. Buxheti është realizuar duke bërë pagesa për projekte të viteve paraprake. Ndërsa niveli i ulët i realizimit të projekteve kapitale sipas zyrtarëve, ka ndodhur si rezultat i pengesave të dala në zbatimin e projekteve në teren.
- Rreziku** Fakti se vetëm një projekt ishte finalizuar në fund të vitit, paraqet një planifikim jo adekuat në raport me realizimin e tyre. Mos realizimi i projekteve sipas afateve mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës në fushën e investimeve kapitale.
- Rekomandimi 2** Ministri duhet të siguroj dhe të përcaktoj objektiva të qarta për përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit në periudhat e ardhshme, dhe të vendosë një monitorim sistematik mbi ekzekutimin e buxhetit dhe realizimit të projekteve.

## 3.2 Pagat dhe shtesat

Shpenzimet për paga dhe mëditje për vitin 2017 ishin 2,063,194€. Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagave janë: kontrolli i pagesave, duke ju nënshtruar listat e pagave, verifikimi i ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, rishikimi i buxhetit dhe barazimet me thesarin.

### Çështja 3 – Paguesa e shtesave për kategoritë e profesioneve deficitare për administratën shtetërore

**E gjetura** Më Vendimin e Qeverisë nr. 07/29, të vitit 2008, për miratimin e shtesave për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare për të gjitha organizatat buxhetore, janë aprovuar 197 pozita dhe në aneksin e bashkangjitur janë përcaktuar pozitat dhe vlera e shtesës. Sipas pikës 6 të këtij vendimi, Ministria e Administratës Publike, në konsultim më Ministrinë e Financave, shqyrton kohë pas kohe listën, standardet kualifikuese dhe shumën e masës stimuluese për postet e caktuara, së paku një herë në gjashtë muaj. Ne kemi identifikuar se:

Prej hyrjes në fuqi të këtij vendimi në vitin 2008, asnjëherë nuk është rishikuar lista apo pozitat e aprovuara. Ndërsa vetëm në MAP janë paguar mesatarisht 113 pozita/shtesa për vitin 2017.

Nga testimet tona të mëtejshme në MAP, kemi identifikuar një rast, se zyrtari i lartë për administrimin e Sistemit të Burimeve Njerëzore gjatë vitit 2017 është paguar me shtesën 500€/muaj, jo në pajtim me vendimin e lartcekur. Po ashtu në nëntë raste zyrtarët janë ngritur në pozitë, kanë marrë shtesat, por nuk ishte nxjerr vendim i veçantë për shtesat përkatëse ashtu siç kërkohet.

**Rreziku** Mungesa e shqyrtimit të standardeve kualifikuese dhe masës stimuluese të të punësuarve në administratën shtetërore, të konsideruar si profesione deficitare, rrit rrezikun që pagesat të bëhen për profesione që tashmë nuk janë deficitare dhe për pozita jo përkatëse. Shpenzimet për shtesa të pozitave të cilave nuk ju takon, shkakton shpenzime shtesë dhe jo të rregullta të buxhetit të ministrisë.

**Rekomandimi 3** Ministri duhet të ndërmarr veprime të menjëhershme që të siguroj menaxhim të mirë të shtesave. Të merren veprime për një shqyrtim që identifikon të gjitha pozitat deficitare aktuale dhe vlerën e saktë financiare të këtyre shpenzimeve. Gjithashtu, të siguroj se të gjithë zyrtarët marrin shtesa sipas pozitave përkatëse, standardeve kualifikuese, të përcaktuara në vendimin e Qeverisë.

---

### 3.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2017 ishte 6,605,054€. Prej tyre janë shpenzuar 6,538,365€ apo rreth 99% nga buxheti i ndarë për këtë kategori. Obligimet e papaguara për mallra dhe shërbime në fund të vitit 2017 ishin 87,000€.

Ministria e Administratës Publike paguan shpenzimet komunale për shumicën e institucioneve (ndërtesave) qeveritare. Shpenzimet komunale për vitin 2017 ishin 2,470,035€ apo 8% më të larta se sa viti paraprak. Kjo për shkak të pagesës së obligimeve të vitit paraprak dhe marrjes nën menaxhim edhe të dhjetë (10) institucioneve tjera nga korriku i vitit 2017.

---

#### Çështja 4 - Pozicionet/hapësirat jashtë kontratës bazë

**E gjetura** Sipas nenit 38 të LPP nr. 04/L-042, me kontratë kornizë shpërblehet një operator ekonomik dhe në këtë rast duhet të përfshihen të gjitha kushtet e nevojshme për të lejuar që porositë të bëhen vetëm në bazë të kontratës.

Nga testimi i pagesave identifikua se në katër fatura të paguara për kontratën "Mirëmbajtja higjienike dhe teknike e ndërtesave qeveritare", Lot 7a, është shtuar objekti/hapësira dhe një pozicion që nuk ishin përfshirë në kontratën bazë. Shuma totale e pagesave për këto pozicione ishte 337€ për muaj, që deri tani nuk e kanë tejkaluar 30% të vlerës së kontratës. Situatë e ngjashme (shtim i objektit) është edhe në katër fatura tjera për kontratën Lot 6a "Mirëmbajtja higjienike dhe teknike e ndërtesave qeveritare".

**Rreziku** Pagesa e pozicioneve/objekteve që nuk janë të përfshira në kontratë tregon një menaxhim jo të mirë të kontratës për këto shërbime. Po ashtu rrit rrezikun që mjetet e shpenzuar nuk kanë arritur qëllimin e duhur.

**Rekomandimi 4** Ministri duhet të siguroj kontrolle të mira në menaxhimin e kontratave duke parandaluar devijimet kontraktuale, për të mundësuar që shërbimet të zhvillohen në pajtueshmëri me kontratat dhe të sigurohet vlera për para.

---

**Çështja 5 – Lidhja e kontratës më procedurë jo adekuate**

**E gjetura** Sipas nenit 35.2 të LPP, lidhja e kontratë me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, mund të bëhet në rastet, kur për arsye teknike ekziston vetëm një operator i mundshëm ekonomik apo për shkak të ekzistimit të të drejtave ekskluzive të autorit, në rastet e urgjencës ekstreme.

Gjatë testimit të pagesave identifikua se me datë 10.10.2017, Ministria ka nënshkruar kontratë në shumë prej 47,988€, në emër të shërbimeve të mirëmbajtës higjienike në Pallatin e Drejtësisë duke përdorur procedura të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Ky lloj i shërbimeve nuk parashihet më nenin e lartë cekur të ligjit. Fillimisht për këtë shërbim AQP kishte zhvilluar procedurat e tenderimit, mirëpo nuk kishte arritur të shpall fituesin, për shkak të ankesave nga OE procesi ishte anuluar nga OSHP. Si rrjedhojë MAP ka zhvilluar këtë lloj procedure.

**Rreziku** Përdorimi i procedurës jo adekuate të prokurimit përveç se nuk është në pajtueshmëri me kërkesat ligjore, nuk promovon konkurrencën dhe rrit rrezikun që për shërbime të tilla të mos arrihet çmimi i tregut.

**Rekomandimi 5** Ministri duhet të siguroj kontrole dhe menaxhim adekuat në fushën e prokurimit. Koordinimi me AQP duhet të zhvillohet me qëllim që të përdoren proceduara adekuate e prokurimit duke promovuar konkurrencë të mirëfilltë dhe të arrihet vlera për para.

**Çështja 6 – Sigurimi i ndërtesave/ pronave shtetërore**

**E gjetura** Sipas nenit 28.4, të LPP, specifikimet teknike duhet të ju referohen standardeve të aplikuara në Kosovë dhe Evropë. Nga testimi i pagesës në vlerë 58,771€, për policat e sigurimit për 58 objekte qeveritare, MAP, në dosje të tenderit kishte vendosur vlera të ndërtesave, të cilat nuk ishin bazuar në dokumente relevante që mbështesin vlerën reale (të tregut) të pronës. Kjo me qëllim që çmimi i policës së sigurimit dhe dëmshpërblimet eventuale të jenë të sakta. Situatë e tillë përsëritet që nga viti 2015 dhe menaxhmenti nuk kishte ndër marr veprime për të përmirësuar këtë situatë.

**Rreziku** Mungesa e dokumenteve relevante për vlerën reale (të tregut) të ndërtesave/pronës qeveritare, mund të ndikoj në çmimin jo adekuat të kontratës (policës së sigurimit) dhe që shpenzimet e bëra të mos arrijnë vlerën për para.

**Rekomandimi 6** Ministri duhet të sigurojë se përgatitja e specifikacionit për sigurimin e ndërtesave qeveritare të bazohet në informata të bazuara për vlerën reale (të tregut) të pasurisë e cila sigurohet, dhe pastaj mbi bazën e kësaj të zhvillohen procedurat e prokurimit.



---

**Çështja 7 - Pagesat direkt nga thesari dhe përmes vendimeve gjyqësore/përmbauesve privat**

**E gjetura** Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, neni 39.2 lejon të bëhen pagesa direkt nga thesari, për faturat që kanë kaluar 60 ditë pa u paguar nga OB. Mbi këtë bazë thesari ka ekzekutuar pagesa në vlerë prej 123,430€, prej kësaj vlere 63,608€ janë paguar nga kodi shërbime tjera kontraktuese, e që realisht është investim kapital-ndërtimi i objekteve administrative.

Ndërsa pagesat nga vendimet gjyqësore ishin në vlerë prej 64,914€. Për shkak të vonesave në ekzekutimet me kohë të obligimeve, tetë pagesa të testuara për vendime gjyqësore kanë rezultuar me pagesën e shpenzimeve shtesë prej 21,659€ apo 33% e pagesës bazë (shpenzime të përmbaimit, gjykatës dhe shpenzime të interesit.

**Rreziku** Moskryerja me kohë e obligimeve ka shkaktuar përballje me gjyqësorin, shpenzime shtesë dhe ulje të reputacionit. Ekzekutimi i pagesave të tilla ndikon në prishjen e ekuilibrit buxhetor dhe rritë rrezikun që projektet e planifikuara me projeksionet fillestare të mos realizohen.

**Rekomandimi 7** Ministri duhet të forcoj kontrollet rreth disiplinës financiare në Ministri. Pagesa e faturave të bëhet në kohë dhe evidenca të plota/sakta mbi detyrimet. Pagesa e detyrimeve të trajtohet me prioritet me rastin e planifikimeve buxhetore.

**Çështja 8 - Shpenzimet e drekave zyrtare**

**E gjetura** Shpenzimet për dreka zyrtare për vitin 2017 janë 44,457€ apo 3% më pak se në vitin paraprak. Pavarësisht kësaj, në pagesën e testuar në shumë 1,064€, përveç faturës në të cilën përshkruheshin numrat e kuponëve fiskal, nuk kishte dokumentacion mbështetës të mjaftueshëm, i cili tregon qartë qëllimin e drekës zyrtare dhe/apo listën e pjesëmarrësve.

**Rreziku** Shpenzimet për dreka zyrtare pa arsytim të qartë të organizimit, shton rrezikun që ministria të paguajë për aktivitete që nuk përkojnë me objektivat e ministrisë dhe fondet publike të shpenzohen në mënyrë jo racionale.

**Rekomandimi 8** Ministri duhet t'i forcojë kontrollet mbi aktivitetet e Ministrisë me rastin e shpenzimeve për dreka zyrtare, më qëllim që këto shpenzime të jenë në funksion të mirëfilltë të përfaqësimit dhe objektivave të ministrisë.



---

**Çështja 9 – Avance të pa mbyllura për udhëtim zyrtare**

- E gjetura** Avancet për udhëtime zyrtare sipas kërkesave ligjore duhet të mbyllen brenda afatit prej 14 ditësh. Ne konstatuam, se shuma prej 673€ nuk ishte mbyllur për më tepër se një vit dhe ende vazhdon të jetë i hapur.
- Rreziku** Avancat e pambyllura me kohë prezantojnë mos respektim të afatit ligjor nga mbajtësit e buxhetit dhe rrezikojnë që paratë e shpenzuara mos të arsyetohen.
- Rekomandimi 9** Ministri duhet të sigurojë se respektohet afati ligjor për mbylljen e avancave duke siguruar llogaridhënie për paranë e shpenzuar si dhe të kërkoj kthimin e mjeteve në kohën sa më shkurtër që është e mundur.

### 3.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 8,555,000€. Prej tyre ishin shpenzuar 8,526,038€. Ministria e Administratës Publike në vitin 2017 ka zhvilluar 97 aktivitete të prokurimit. Sipas listës së prokurimit MAP ka pasur edhe nëntë aneks kontrata si punë shtesë në shumë prej 859,451€ për 20 kontrata pune. Ne vijim do të prezantojmë të gjeturat të cilat kanë dalë nga rishikimi i pagesave dhe dosjeve të prokurimit:

---

**Çështja 10 - Pagesa për punët e pakompletuara/pakryera**

- E gjetura** Kushtet e kontratës për lënden ‘Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Novobërdë’, përcaktojnë se pagesat do të bëhen në bazë të situacioneve të cilat ofrohen nga operatori ekonomik dhe aprovohen nga organi mbikëqyrës.
- Me datën 21.12.2017 në emër të kësaj kontrate është paguar shuma prej 43,931€ për situacionin e katërt. Organi mbikëqyrës ka përgatitur planin për menaxhimin e kontratës me datën 20.12.2017 duke theksuar se situacioni i katërt mund të paguhet. Mirëpo më datën 13.03.2018 kemi ekzaminuar këtë projekt në terren dhe kemi vërejtur se tri pozicione të cilat kishin të bënin për punimet e dyerve dhe dritareve nuk ishin kryer, ndonëse ishin pranuar si të kryera dhe ishin paguar. Shuma totale për këto punë të pakryera është 9,440€. Sipas organit mbikëqyrës pagesat janë bërë me pretendimin/arsyetimin se projekti është në vijim dhe operatori ekonomik deri në fund të vitit 2017 do të përfundoj punët e pakryera.

**Rreziku** Ekzekutimi i pagesës për punët e pakryera është në kundërshtim me rregullat/kontratën po ashtu rritë rrezikun që përkundër pagesës punët të mos kryhen fare. Në këto raste rrezikohet arritja e vlerës për para dhe llogaridhënia ndaj qytetarëve. Rasti i identifikuar nga auditimi është tregues për rreziqet e tilla në Ministri.

**Rekomandimi 10** Ministri duhet të siguroj mbikëqyrje dhe kontrole adekuate/rigoroze mbi kontratat për projekte kapitale dhe mbi organet mbikëqyrëse të punëve. Në bazë të rastit të identifikuar nga auditimi, menaxhmenti të ngrisë mekanizmat për kontroll më të avancuar në mbikëqyrjen e kontratave dhe pagesave për projektet kapitale.

### Çështja 11 – Avance për projektet kapitale

**E gjetura** Neni 26.2 i kushteve të kontratës përcakton se kontraktuesi do të përdor parapagimin vetëm për blerje të materialit, pajisjeve dhe shpenzimeve tjera posaçërisht për kryerjen e punëve. Po ashtu kontraktuesi duhet të prezantoj kopje të faturave të furnizimit për menaxherin e projektit.

Për projektin "Ndërtimi i Shkollës fillore" në Rahovec, më datën 04.04.2017, është paguar në formë të avancit shuma prej 200,000€. Kjo është bërë në bazë të kushteve të kontratës, si dhe duke iu referuar ligjit për buxhet. Por përveç, faturës për avancë nuk kemi gjetur ndonjë situacion apo përkshkrim të punëve të cilat do të kryhen nga punë-kryesi, siç do të ishin punët përgatitore të terrenit, furnizim më pajisje/material apo të ngjashme.

Avance në forma të tilla, pa arsyeshmëri të mjaftueshme janë paguar edhe në dy raste tjera. Më datën 15.06.2017 ishte paguar shuma prej 44,900€ në emër të projektit "Ndërtimi i impiantit në qendrën e paraburgimit në Prishtinë" si dhe për projektin "Ndërtimi i shkollës fillore në Ponoshec" të Gjakovës, më datën 06.06.2017 është paguar në avancë shuma prej 47,038€.

**Rreziku** Mënyra/dukuria e dhënies së avancave nga MAP pa dëshmi të mjaftueshme nga OE për punët, blerjen e pajisjeve apo furnizimeve, mund të sjellë rreziqe që paraja publike të mos justifikohet siç duhet nga OE dhe autoriteti kontraktues.

**Rekomandimi 11** Ministri duhet të rrisë kontrollat në menaxhimin e shpenzimeve për projekte kapitale dhe të siguroj se paradhëniet do të ndodhin me arsyeshmëri të duhur sipas kërkesave ligjore dhe kontraktuale.

---

## 3.5 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

---

### Çështja 12 – Lidhja e kontratave me zotim të pjesshëm

**E gjetura** Sipas nenit 36.1 të LMFPP, nr.03/L-048, autoritet kontraktuese duhet të zotojnë mjete para inicimit të procesit të prokurimit që rezulton me ngritjen e obligimit aktual. MAP kishte kryer procedura të prokurimit për projektin 'Impianti për trajtimin e ujërave të zeza në qendrën e paraburgimit në Prishtinë' edhe pse nuk kishte fonde në disponueshmëri. Sipas dokumentacionit të ofruar vlera e parashikuar për këtë projekt ishte 300,000€ derisa disponueshmeria e mjeteve për këtë projekt ishte vetëm 50,000€. Më qëllim të realizimit të këtij projekti MAP ka kryer transferin e mjeteve prej 250,000€ nga projekti "Ndërtimi i UM".

Ne tri raste zotimet ishin të pjesshme në raport me planifikim dhe një rast zotimi nuk ishte përkatës për kontratën e nënshkruar.

**Rreziku** Lidhja e kontratave në mungesë të fondeve të mjaftueshme përmban në vete rrezikun se projektet e filluara do të ngecin si në aspektin e realizimit ashtu edhe në kryerjen e obligimeve të kontraktuara.

**Rekomandimi 12** Ministri duhet të sigurojë që zyrtaret përgjegjës të buxhetit të përgatitin planifikimin e projekteve mbi bazën e disponueshmerisë së fondeve. Po ashtu të siguroj se nuk do të fillojnë asnjë projekt pa pasur fonde të mjaftueshme.

### 3.6 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Gjatë vitit 2017, MAP ka bërë një progres të dukshëm në aspektin e regjistrimit të pasurive në krahasim me vitin paraprak. Përkundër progresit, të bërë për bartjen e pasurisë që ishte edhe Theksim i çështjes vitin e kaluar, menaxhimi i saj ende mbetet sfidë për ministrinë. Megjithatë planifikimi i shpenzimeve në tabelat buxhetore si shpenzime kapitale ndonëse ato janë mallra dhe shërbime kane pasur si rezultat mbivlerësimin e investimeve kapitale e njëkohësisht edhe Theksimin e çështjes së opinionit për vitin 2017.

#### Çështja 13 – Mos harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrin e pasurisë

**E gjetura** Sipas nenit 19.6, të rregullores për menaxhimin e pasurisë nr.02/2013, të gjitha ndryshimet në numërimin ose vlerën e pasurive të cilat përcaktohen pas inventarizimit duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive dhe regjistrin kontabël.

Komisioni i inventarizimit, përmes raportit në fund të vitit ka sugjeruar se pasuritë e dëmtuara në depot Graçanicë dhe Rilindja, të hudhën apo të shiten. Lidhur me këtë janë marrë veprime në vitin 2018 por nuk janë reflektuar në PFV-të aktuale/2017.

**Rreziku** Mos harmonizimi i gjendjes së inventarizimit me gjendjen në regjistrin kontabël, rrisin rrezikun që pasuritë të keqpërdorën, humben apo të tjetërsohen si dhe pasuria e organizatës e pasqyruar në PFV të mos jetë e saktë.

**Rekomandimi 13** Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë që menaxhimi i pasurisë bëhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe prezantimit të saktë të pasurisë në PFV.

### 3.7 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 183,000€, deri sa në vitin 2016 ishin 760,000€. Pra, vërehet një ulje prej 577,000€. Po ashtu, në fund të vitit janë prezantuar detyrimet kontingjente si konteste gjyqësore në shumë 2,660,000€ deri sa në vitin paraprak ishin 3,322,000€.

---

**Çështja 14 - Menaxhim i dobët i detyrimeve**

- E gjetura** Sipas nenit 17.2 të rregullores 01/2017, organizatave buxhetore nuk i lejohet të hyjnë në detyrime gjatë vitit aktual fiskal në një shumë që i tejkalon fondet e ndara. Në fund të vitit 2017 ishin regjistruar obligime nga kategoria mallra dhe shërbime në shumë 87,000€ deri sa shuma e mbetur e buxhetit për këtë kategori ishte 66,689€. Gjendje e njëjtë ishte edhe te shërbimet komunale ku obligimet ishin në vlerë prej 45,000€, përderisa buxheti i pashpenzuar ishte 1,065€ si dhe te investimet kapitale obligimet ishin në vlerë prej 51,000€, derisa mjetet e pashpenzuara ishin vetëm 28,962€. Kjo tregon se ministria kishte hyrë në obligime pa fonde për 86,284€.
- Rreziku** Fakti se ministria ka hyrë në obligime përtej ndarjeve buxhetore për kategoritë ekonomike të lartcekura mund të ketë si rrezik që një pjesë e buxhetit e vitit vijues të shpenzohet për obligimet e mbetura nga viti paraprak.
- Rekomandimi 14** Ministri duhet të siguroj se shpenzimet e buxhetit i përmbahen kufijve buxhetor dhe mbi këtë bazë të bëhet planifikimi i buxhetit dhe plani i rrjedhës së pasasë, duke mos tejkalar buxhetin në dispozicion.

**Çështja 15 - Niveli i lartë i detyrimeve kontingjente**

- E gjetura** Niveli i shpenzimeve të mundshme nga detyrimet kontingjente është i lartë. Në PVF është paraqitur vlera 2,660,000€, që është një trend më i ulët krahasuar me vitin paraprak. Në vitin 2016 ishin 3,322,000€. Ndërsa sipas të dhënave nga Avokatura Shtetëror janë nëntë lëndë/padi ndaj MAP, pa ndonjë vlerë financiare.
- Rreziku** Mungesa e një qasje adekuate për trajtimin e detyrimeve kontingjente rrit mundësinë e shndërrimit të tyre në obligime faktike që do të shkaktonte keqësimin e pozitës financiare të ministrisë.
- Rekomandimi 15** Ministri duhet të siguroj se detyrimet kontingjente trajtohen me kujdes me qëllim të planifikimit më të mirë financiar, të analizojë shkaqet e ndodhjes së tyre me qëllim të parandalimit të kësaj dukurie. Në koordinim më Avokatin Shtetëror të sigurohen informata/dëshmi që të sigurohet përfaqësim adekuat i këtyre rasteve/lëndeve.

---

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016 të ministrisë ka rezultuar me 15 rekomandime. Ministria ka përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Në auditimin e vitit 2017 kemi vlerësuar se tre rekomandime nuk janë zbatuar nga viti 2015 dhe katër ishin në proces të zbatimit. Po ashtu nga rekomandimet e dhëna për vitin 2016, pesë rekomandime janë zbatuar, gjashtë pjesërisht dhe katër nuk janë zbatuar. Për më shumë detaje referojuni shtojcës II.

---

### Çështja 16 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

- E gjetura** Nga rekomandimet e dy viteve paraprake kemi identifikuar se ka ende rekomandime të pa zbatuara dhe disa ende janë në proces të zbatimit, si rrjedhojë mangësitë në sistemet domethënëse mbesin të pa trajtuara.
- Rreziku** Mungesa e zbatimit të plotë të rekomandimeve të dhëna shton rrezikun që dobësitë e identifikuara në sistemet kryesore të MAP-it të përsëritën.
- Rekomandimi 16** Ministri duhet të siguroj se do të hartohet një plan veprimi i rishikuar ku janë vendosur zyrtarët përgjegjës, aktivitetet dhe afatet kohore për zbatim. Procesi duhet të monitorohet në bazë periodike nga menaxhmenti.

## 5 Qeverisja e mirë

### Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në lidhje me qeverisjen e mirë ne vlerësojmë progresin që ka bërë MAP në hartimin e listës së rreziqeve, si dhe planin e veprimit. Edhe pse MAP ka hartuar një plan të integritet për vitet 2017-2020 duke caktuar pesë objektiva kryesore, kjo paraqet vetëm një hap për një qeverisje të mirë. Këtij plani duhet shtuar plani/veprimet për zbatim.

Një numër i dobësive të qeverisjes brenda MAP-it u cekën më lartë në lidhje me moszbatimin e plotë të rekomandimeve nga vitet paraprake, po ashtu duhet shtuar edhe mungesën e rregullave në angazhimin e trajnerëve në IKAP dhe ndikimin e ulët të auditimit të brendshëm në rritjen e efikasiteti të kontrolleve të brendshme.

## 5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe një auditor, të cilët janë të licencuar. NJAB ka planin vjetor, të aprovuar nga Ministri dhe Komiteti i Auditimit, i cili është i bazuar në planin strategjik. AB kishte planifikuar dhe kryer shtatë auditime. AB kishte raportuar në baza të rregullta tre mujore. Të gjeturat tona janë përmbledhur më poshtë:

### Çështja 17 - Funksionimi i dobët i NjAB

**E gjetura** Parregullsitë të cilat i kemi identifikuar në funksionimin e NjAB-së janë si në vijim:

- Katër nga shtatë raportet e kryera, përfshijnë periudhën e vitit 2017;
- Në dosje të auditimit të brendshëm mungonin shumica e letrave të punës që kërkohet me doracakun e përgatitur nga NJQHAB;
- Prej shtatë njësive të audituara, vetëm katër prej tyre kishin përgatitur planet e veprimit. Përderisa niveli i zbatimi të rekomandimeve ishte shumë i ulët (27%); dhe
- Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk ishte mjaftueshëm funksional. Kishte mbajtur vetëm një takim në fillim të vitit 2017 më fokus në tremujorin e vitit të kaluar.

**Rreziku** Dosjet e pakompletuar, fokusimi në pjesën më të madhe të raporteve në vitin paraprak nga NjAB si dhe mosfunksionimi i plotë i KA ndikojnë që Ministria të përfitojë pak nga kjo njësi. Përderisa, niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga ana e njësive të audituara rrit rrezikun që gabimet dhe mangësitë e identifikuara të mos korrigjohen dhe të përsëriten në vazhdimësi.

**Rekomandimi 17** Ministri duhet të siguroj funksionimin e duhur të kontrolleve të brendshme në Ministri. Në këtë aspekt duhet siguar funksionimi i plotë i KA si dhe punë/auditime cilësore të NJAB. Më tutje, Menaxhmenti duhet siguroj zbatimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga NJAB.



---

## 5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

Procesi i raportimit të brendshëm në MAP funksionon sipas zingjirit llogaridhënës dhe sipas ligjit dhe strukturës organizative. Lidhur me këtë, menaxhmenti mban takime të rregullta me të gjithë drejtuesit e departamenteve, ku pjesëmarrës shpeshherë është edhe Ministri duke diskutuar raportet dhe çështjet tjera për të gjitha aktivitetet e saj. Departamentet raportojnë në baza javore në lidhje me aktivitetet e tyre.

---

### Çështja 18 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut/projekteve

**E gjetura** Dobësitë e vërejtura në këtë fushë ndërlidhen me kontratat e projekteve kapitale, menaxhimin e obligimeve, rregulloret e IKAP-it si dhe përmbajtja e planit të integritetit:

- Kontrolli dhe menaxhimi i kontratave për projekte kapitale nuk është në nivel të mirë. Pothuaj në të gjitha kontratat për projekte kapitale janë paguar avance të pa arsyetuara mirë. Pastaj në disa projekte janë lidhur aneks kontrata e madje në një rast punët/pozicionet e pakryera janë raportuar si të kryera;
- Në projektin "Ndërtimi i objektit të Universitetit të Mitrovicës"- për fazën II dhe fazën III punët shtesë janë në vlerë prej 592,433€ (faza II 253,391€ dhe faza III 339,042€). Punët shtesë ndërlidhen më ndryshimin/shtimin e sasive në disa pozicione bazë, siç janë punët e armimit, betonit, punët metalike, hidroizolimi, armatur, mureve dhe punë të oborrit. Vlerat financiare të punëve shtesë nuk kanë tejkaluar vlerën 10% në totalin e kontratave, dhe janë ndjekur procedurat. Megjithatë kjo nuk është praktikë e mirë dhe tregon për procesin e dobët në planifikimin i projekteve dhe mungesës së revidimit me kohë të tyre;
- Menaxhimi jo i mirë i obligimeve dhe pagesave/faturave ka ndikuar që ministria të paguaj shpenzime shtesë prej 21,659€, për përmbaruesit privat, gjykatë dhe shpenzime të interesit; dhe
- MAP nuk ka arritur të bëjë një rregullore e cila i definon procedurat e formalizuara në lidhje me angazhimin e trajnerëve në IKAP, si dhe në planin e integritetit nuk ka plan se si të menaxhohet dhe vepohet në rast të mashtrimit apo korrupsionit të mundshëm.

**Rreziku** Mungesa e kontrolleve adekuate/të mira ekspozon MAP-in para sfidave rreth menaxhimit adekuat të kontratave, obligimeve rrjedhimisht parasë publike. Mungesa e rregulloreve për trajnerë në IKAP shfaqë dobësi në ngritjen e cilësisë së administratës publike. Ndërsa mungesa e një plani veprimi si përgjigje ndaj rasteve të mundshme të mashtrimit apo korrupsionit do të ndikoj në reagime të dobët ndaj këtyre rasteve.

**Rekomandimi 18** Ministri duhet të siguroj cilësi në raportimet financiare dhe operative të Ministrisë. Te siguroj menaxhim dhe kontrolle efektive në realizimin e projekteve/kontratave për organizatat tjera. Gjithashtu, një qasje e planifikuar dhe e formalizuar për proceset/programet në kuadër të IKAP. Në planin e integritet të përfshihen definojnë veprimet rigoroze ndaj rasteve të mundshme të mashtrimit apo korrupsionit.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

*Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit*

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Ministri duhet të siguroj se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar		Pjesërisht	
2.6 Auditimi I brendshëm	Ministri duhet të siguroj se përfitimi nga puna e NjAB merret në konsideratë duke përgatitur plan veprimi për implementimin e rekomandimeve dhe ndërmarrjen e masave konkrete në implementimin e tyre.		Pjesërisht është zbatuar	
3.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Ministri duhet të sigurojë se ka analizuar arsyet për mos ekzekutimin e buxhetit për investime kapitale dhe mallra dhe shërbime në mënyrë sistematike gjatë vitit dhe të ndërmerr masa që ti eliminojë dobësitë qoftë në fazën e planifikimit ose ekzekutimit të buxhetit.		Pjesërisht është zbatuar	
3.4 Prokurimi	Ministri duhet të siguroj se ka shtuar kontrollet mbi proceset e prokurimit, e në veçanti në inicimin e procedurave të prokurimit nga njësitë kërkuese, të cilat duhet të bëhen në periudha më të hershme dhe të bazuara në analiza të mjaftueshme. Më tutje, kur do që një OE eliminohet nga pjesëmarrja e mëtutjeshme duhet të informohet për arsyet e eliminimit.			Jo
3.4 Prokurim	Ministri duhet të sigurojë se para inicimit të procedurave të prokurimit bëhet vlerësimi i projekteve nëse ato janë përgatitur në përputhje me nevojat reale dhe se i plotësojnë kriteret teknike dhe profesionale dhe të bëhet revidimi i tyre me kohë për t'i evituar punët shtesë.			Jo

3.4 Prokurim	Ministri duhet të siguroj se aktivitetet ekzistuese të kontrollit dhe monitorimit gjatë realizimit të projekteve kapitale janë rishikuar. Me theks, kontrollet në fazën fillestare të projekteve për investime kapitale duhet të shtohen për të siguruar që projektet bëhen duke u bazuar në nevojat reale dhe përmbushjen e tyre sipas afateve kohore të parapara në planin dinamik. Si dhe realizimin e sigurisë së ekzekutimit në rastin e mos kryerjes së punimeve sipas kontratës.			Jo
3.7.2 Trajtimi i obligimeve	Ministri duhet ndërmerr masa konkrete për të siguruar një planifikim më të mirë të buxhetit dhe procesimin e pagesave sipas afatit kohorë në mënyrë që vlera e obligimeve të papaguara të ulet në nivel minimal.		Pjesërisht	
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.2Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim	Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë e detajuar për përcaktimin e shkaqeve që kanë ndikuar në theksimin e çështjes. Në këtë aspekt, shpenzimet duhet të buxhetohen dhe shpenzohen sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik. Pasuritë kapitale të cilat janë ndërtuar për organizata tjera të transferohen me kohë të institucionet të cilat i posedojnë pasuritë dhe lista e stokut të prezanton vetëm pasuritë që e kanë karakterin e stokut. Me tutje, menaxhmenti duhet të bëjë një rishikim detaj të draft PFV-ve, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime.	Po		
	Ministri duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar se informatat e raportuara për menaxhmentin dhe palët tjera të interesit të rishikohen në mënyrë kritike para se ato të dorëzohen, me qëllim të evitimit të kësaj dukurie.	Po		

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë që plani i veprimit, duhet të rishikohet duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor për zbatimin e rekomandimeve, përfshirë edhe stafin llogaridhënës. Në fokus fillestar duhet të jenë fushat e një rëndësie më të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të monitorohet në vazhdimësi.		Pjesërisht	
2.2 Pyetësori i vlerësimit të komponentëve të MFK-së	Ministri duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut të një drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë duke monitoruar menaxhimin e rreziqeve.		Pjesërisht	
2.2.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Ministri duhet të sigurojë përmes menaxhmentit të IKAP-it vendosjen e rregullave dhe procedurave të shkruara në procesin e angazhimit të trajnerëve. Në këtë aspekt, eliminohet subjektivizmi duke ndikuar që vendimmarrja dhe llogaridhënia të jetë e formalizuar.			Jo
2.3 Sistemi i auditimit të brendshëm	Ministri duhet të sigurojë një bashkëpunim të ngushtë dhe komunikim efektiv në mes menaxhmentit, KA dhe NjAB-së për të identifikuar mangësitë e kontroleve të brendshme dhe për të ndërmarrë veprime shtesë që rekomandimet e kësaj njësie të gjejnë zbatim në praktikë. Më tej, KA duhet të forcojë rolin e vet në këtë proces, duke e mbajtur menaxhmentin më përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve.		Pjesërisht	
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Ministri duhet të sigurojë që përgatitjet në lidhje me projektet kapitale janë të analizuar mirë dhe memorandumet në lidhje me projekte arsimore të arrihen më herët për të mundësuar zhvillimin e procedurave të prokurimit në kohën e duhur.		Pjesërisht	
3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Ministri duhet të sigurojë se përgatitja e specifikacionit për sigurimin e ndërtesave qeveritare bazohet në informata zyrtare dhe shënime valide për vlerën reale të pasurisë e cila sigurohet, dhe pastaj mbi bazën e kësaj të zhvillohen procedurat e prokurimit.			Jo

	Ministri duhet të kërkoj llogari nga ana e Thesarit në raste të tilla dhe të veprojë në mënyrë proaktive që të shmangen pagesat e tilla që e dëmtojnë buxhetin e MAP-it. Po ashtu, duhet siguruar që janë ndërmarrë veprime të nevojshme në mënyrë që mangësitë e njëjta të mos përsëriten dhe se kjo çështje të mos bëhet dukuri në ministri.			Jo
	Ministri duhet të siguroj se procedurat e prokurimit për kontratat që pritet të skadojnë të fillojnë më herët dhe të marrin në konsideratë të gjitha pengesat dhe vonesat e mundshme në mënyrë që kontrata të lidhet para skadimit të kontratës së vjetër.	Po		
3.1.3 Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të sigurojë se dhënia e subvencioneve mbështetet nga një monitorim gjatë fazës së përmbushjes së projektit, në mënyrë që të sigurohemi që mjetet janë shpenzuar sipas kërkesës së paraqitur në projekt propozim.	Po		
3.1.4 Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj se përgatitjet fillestare nga ana e MAP-it për çdo projekt duhet të jenë gjithëpërfshirëse në mënyrë që të parandalohen pengesat të cilat mund të dalin në proces të zbatimit të çdo projekti.			Jo
	Ministri duhet të siguroj përmes menaxherit të prokurimit se procesi i vlerësimit është në harmoni të plotë me kriteret e vendosura dhe trajtimi i operatorëve është i njëjtë. Një mbikëqyrje të procesit të vlerësimit para nënshkrimit të kontratës duhet ta siguroj edhe vetë menaxheri i prokurimit.	Po		
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë që proceset e menaxhimit të pasurisë janë transparente dhe bëhen në përputhje të plotë me rregullën për menaxhimin e pasurive si me rastin e tjetërsimit ashtu edhe me inventarizim.		Pjesërisht	



---

3.3 Obligimet	Ministri duhet të sigurojë se është vendosur një sistem efikas ku faturat pranohen dhe raportohen saktë si për MF-në ashtu edhe për menaxhmentin. Po ashtu në raportimet mujore duhet të përcjellët kronologjia e faturave të papaguara në mënyrë që faturat e papaguara të raportohen deri sa të paguhen, në mënyrë që menaxhmenti dhe Thesari të kenë informacione të sakta për obligimet e mbetura. Po ashtu menaxhmenti duhet të trajtoj me kujdes të shtuar edhe trendin në rritje të detyrimeve kontingjente.		Pjesërisht	
---------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	------------	--

## Shtojca III: Letërkonfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
 QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT  
 MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE-MINISTARSTVO JAVNE ADMINISTRACIJE  
 MINISTRY OF PUBLIC ADMINISTRATION  
 ARKIVA / ARCHIVA / ARCHIVE  
**DALËSE**  
 Nr/Bc.No. 1428  
 Nrfaq/Bc.st/No.pg  
 Data/Datum/Date: 03.05.2018  
 PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
 ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
 NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE  
 03.05.2018  
 DATE PRANUAR/DORËZUAR:  
 DATUM PRINIJE/DOŠAVLJEN:  
 DATE RECEIVED/SUBMITTED:  

Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
03	401	612	1



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government  
 Ministria e Administratës Publike /Ministarstvo Javne Uprave /  
 Ministry of Public Administration

## LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit  
 Të nderuar,  
 Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Administratës Publike, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Mahir Yagcilar .....  
 Ministër i Ministrisë së Administratës Publike,  
 Data: 03.05.2018, Prishtinë,